



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

K.DH.SH.II.nr.748/22

GJYKATA KOMERCIALE -Dhoma e Shkallës së Dytë, me gjyqtaren individuale Saranda Bogaj Sheremeti, në çështjen juridike përmbarimore të kreditorit Kompania Rajonale e Ujësjellësit, SH.A KUR, Mitrovica J.S.C, me adresë R. Bislim Bajgora, p.n Mitrovicë, kundër debitorit – M.O, me adresë Rr. në Mitrovicë, me bazë juridike përmbarimore, duke vendosur lidhur me ankesën e debitorit të paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Mitrovicë-Departamenti i Përgjithshëm, PPP.nr.968/20, i datës 10.02.2021, me datë 01.09.2022, mori këtë:

A K T V E N D I M

I. APROVOHET e themeltë ankesa e debitorit – M.O, me adresë Rr., në Mitrovicë, NDRYSHOHET aktvendimi i Gjykatës Themelore në Mitrovicë-Departamenti i Përgjithshëm, PPP.nr.968/20, i datës 10.02.2021, ashtu që çështja gjykohet si në vijim: PRANOHET i bazuar prapësimi i debitorit –M.O, me adresë Rr. në Mitrovicë, SHFUQIZOHET (vihet jashtë fuqie), urdhri për lejimin e përmbarimit P.nr.3729/20, i datës 09.10.2020, dhe anulohen të gjitha veprimet e ndërmarra përmbarimore, ndërsa propozimi për përmbarimi i kreditorit Kompania Rajonale e Ujësjellësit, SH.A KUR, Mitrovica J.S.C, me adresë R. Bislim Bajgora, p.n Mitrovicë, REFUZOHET I PABAZUAR.

II. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Mitrovicë-Departamenti i Përgjithshëm, me aktvendimin PPP.nr.968/20, i datës 10.02.2021, ka vendosur të refuzoj si të pabazuar prapësimin e debitorit –M.O, me adresë Rr. në Mitrovicë, i paraqitur kundër urdhrit për lejimin e përmbarimit P.nr.3729/20, i datës 09.10.2020.

Kundër këtij aktvendimi me kohë ka parashtruar ankesë debitori për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës dhe konstatimit të gabuar të gjendjes faktike , për çka i ka propozuar gjykatës se shkallës së dytë që ta aprovoi ankesën e debitorit dhe ta refuzoj ekzekutimin e aktvendimit mbi lejimin e përmbarimit, dhe aktvendimin e kundërshtuar ta prish dhe çështjen ta kthej në rivendosje.

Nga shkresat e lëndës u vërtetua se përgjigje në ankesë nuk ka paraqitur kreditori .

Gjyqtari individual i Gjykatës Komerciale Dhoma e Shkallës së Dytë, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar dhe pretendimet ankimore, në kuptim të nenit 3, paragrafi 2, të Ligjit nr.04/L-139 për Procedurën Përmbarimore si dhe në kuptim të nenit 194 të LPK-së, gjeti se:

-Ankesa e debitorit është e themeltë.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditori Kompania Rajonale e Ujësjiellit, SH.A KUR, Mitrovica J.S.C, me adresë R. Bislim Bajgora, p.n Mitrovicë, me datë 09.10.2020, ka paraqitur propozim për përmbarim ndaj debitorit –M.O, me adresë Rr. në Mitrovicë , në bazë të dokumentit të besueshëm- faturës me numër me të cilën ka kërkuar që në emër të borxhit, t'ia paguajë shumën prej 982.38 Euro, me kamatë prej 8% nga dita e arritjes së kërkesës për pagesë si dhe shpenzimet e procedurës përmbarimore e të gjitha këto në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimit të këtij urdhri.

Përmbaruesi Atip Mustafa me seli në Vushtri duke vepruar sipas propozimit për përmbarim të kreditorit ka lejuar përmbarimin me urdhrin P.nr. 8378/20, i datës 09.10.2020, ndërsa kundër këtij urdhri debitori ka ushtruar prapësim me datën 21.10.2020, duke theksuar se debitori në asnjë rast nuk e ka kundërshtuar borxhin të cilin e ka kundrejt kreditorit, mirëpo i kundërshtojmë faktin se kreditori asnjëherë nuk ka dërguar fatura te debitori dhe për këtë arsye nuk kemi mundur të bëjmë pagesën e faturave dhe se jemi të gatshëm të bëjmë pagesën e borxhit sipas faturave. I ka propozuar gjykatës që pas shqyrtimit të këtij prapësimi të merr aktvendim me të cilin do të aprovohet prapësimi si i bazuar.

Përgjigje në prapësim nuk ka ushtruar kreditori .

Gjykata Themelore në Mitrovicë-Departamenti i Përgjithshëm pas vlerësimit të prapësimi, ka nxjerrë aktvendimin e atakuar PPP.nr.968/20, i datës 10.02.2021, ka vendosur që ta refuzoj prapësimin e debitorit, duke vendosur si në dispozitiv të aktvendimit të atakuar.

Në arsyetim të aktvendimit të atakuar gjykata ka theksuar se nuk janë plotësuar asnjëra nga shkaqet e parapara me nenin 71 të LPP-së, e po ashtu përmbaruesi privat e ka nxjerrë urdhrin përmbarimor në pajtim të plotë me dispozitën e nenit 29 paragrafi 1 pika 1.2, pasi që fatura paraqet dokument të besueshëm, andaj edhe propozimi për

përmbarrim nga ana e gjykatës është vlerësuar i bazuar dhe ka vendosur që në kuptim të dispozitave të nenit 43, 73 pika 1, 2 dhe 3 të LPP-së, ta refuzojë prapësimin e debitorit.

Dhoma e Shkallës së Dytë vlerëson se përfundimi dhe qëndrimi juridik i gjykatës së shkallës së parë është i gabuar pavarësisht se aktvendimi i atakuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika b), g), j), k) dhe m) e LPK-së, për të cilat Dhoma e Shkallës së Dytë kujdeset sipas detyrës zyrtare, as në shkelje tjera të pretenduara, ndërsa gjendja faktike nuk është vërtetuar në mënyrë të plotë dhe të drejtë, prandaj Dhoma e Shkallës së Dytë ka vendosur që ta ndryshoj aktvendimin e gjykatës së shkallës së parë.

Në këtë rast Dhoma e Shkallës së Dytë gjeti se në shkresat e lëndës është dëftesa bankare me nr. të referencës e datës 16.10.2020 me të cilën vërtetohet se debitori ka përmbushur në tërësi obligimin ndaj kreditorit , fakt për të cilin ka qenë në dijeni kreditori për çka ka qenë dashur ta njoftoj edhe përmbarruesin privat në mënyrë që të ndërprehet procedura përmbarrimore.

Titulli përmbarrues është ai mbi bazën e të cilit inicohet procedura e përmbarrimit dhe realizohet kërkesa e përmbajtur në të. Dhoma e Shkallës së Dytë vlerëson se në rrethana të tilla nuk ka pasur kushte ligjore të vazhdohet procedura e përmbarrimit edhe pse është iniciuar sepse gjashtë ditë pasi që është paraqitur propozimi për përmbarrim është përmbushur obligimi nga ana e debitorit, kjo pasi që fatura në bazë të cilit është iniciuar procedura përmbarrimore nuk është i përshtatshëm për përmbarrim, ashtu siç është përcaktuar me nenin 27 të LPP.

Nga këto arsye, marrë për bazë pretendimin ankimor të palës ankuese rreth zbatimit të gabuar të gjendjes faktike për shkak të mos verifikimit të provave të parashtruara në këtë çështje, Dhoma e Shkallës së Dytë vlerëson ndryshe provat nga shkresat e lëndës dhe gjen se në rastin konkret plotësohen kushtet ligjore që aktvendimi i ankimuar të ndryshohet, të shfuqizohet urdhri për lejimin e përmbarrimit dhe të refuzohet propozimi për përmbarrim, ashtu siç është përcaktuar me nenin 201 pika b) dhe d) të LPK-së.

Sa u përket shpenzimeve të procedurës, u vendos konform dispozitës së nenit 450 të LPK-së duke vendosur që secila palë t'i bartë shpenzimet e veta, pasi që e debitori nuk i kishte kërkuar shpenzimet e procedurës.

Kompetenca e Gjykatës Komerciale Dhoma e Shkallës së Dytë për të vendosur nga ana e gjyqtarit individual në shkallë të dytë bazohet në dispozitën e nenit 3 par. 2 të LPP, me të cilën është paraparë se në shkallën e dytë vendimet i nxjerr gjyqtari individual.

Nga sa u tha me lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi në kuptim të nenit 77 dhe 17 të LPP-së, lidhur me nenin 208 dhe 209, pika b), të LPK-së.

GJYKATA KOMERCIALE NË PRISHTINË- Dhoma e Shkallës së Dytë

K.DH.SH.II.nr.748/22, data 01.09.2022

Gjyqtarja
Saranda Bogaj Sheremeti